



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:128271

Datë: 05.04.2024

Numri i dokumentit: 05554471

KPPP.nr.895/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Insu Trade” SH.P.K., me NUI: 811296955, me seli në Lagjen Ulpiana, U-1 H.I. Nr.7, në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë Fisnik Sogojeva dhe Adelina Isufi, avokatë nga Prishtina, kundër debitorit “Alba Group” SH.P.K., me NUI: 810829864, me seli në rr. “Ukshin Hoti” nr.49, në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë Basri Jupolli dhe Arlind Jupolli, avokatë nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.261/22 të datës 01.06.2022, të Përmbartuesit Privat Rezarta Metaj me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 05.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Alba Group” SH.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.261/22 të datës 01.06.2022, të Përmbartuesit Privat Rezarta Metaj.
- II. MBETET në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.261/22 i datës 01.06.2022 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Rezarta Metaj.
- III. DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim t’ia paguaj kreditorit shumën prej 104.00 € (njëqind e katër euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbaresi Privat, duke vepruar sipas propozimit të autorizuarve të kreditorit “Insu Trade” SH.P.K., ka lëshuar urdhrin përmbarimor P.nr.261/22 të datës 01.06.2022, me të cilin ka lejuar përmbarimin, në bazë të dokumentit të besueshëm: Faturës Nr. 1309 të datës 04.11.2019; Faturës Nr. 1692/2021 të datës 16.11.2021; Faturës Nr. 1324/2021 të datës 16.09.2021; Faturës Nr. 1226/2021 të datës 30.08.2021; Faturës Nr. 1225/2021 të datës 30.08.2021; Faturës Nr. 1169/2021 të datës 17.08.2021; Faturës Nr. 1148/2021 të datës 12.08.2021; Faturës Nr. 1070/2021 të datës 02.08.2021; Faturës Nr. 1049/2021 të datës 27.07.2021; Faturës Nr. 992/2021 të datës 14.07.2021; Faturës Nr. 965/2021 të datës 09.07.2021; Faturës Nr. 954/2021 të datës 06.07.2021; Faturës Nr. 923/2021 të datës 02.07.2021; Faturës Nr. 905/2021 të datës 28.06.2021; Faturës Nr. 904/2021 të datës 26.06.2021; Faturës Nr. 903/2021 të datës 25.06.2021; Faturës Nr. 870/2021 të datës 21.06.2021; Faturës Nr. 703/2021 të datës 25.05.2021; Faturës Nr. 700/2021; Faturës Nr. 695/2021 të datës 25.05.2021; Faturës Nr. 669/2021 të datës 21.05.2021; Faturës Nr. 639/2021 të datës 12.05.2021; Faturës Nr. 626/2021 të datës 10.05.2021; Faturës Nr. 610/2021 të datës 05.05.2021; Faturës Nr. 569/2021 të datës 27.04.2021; Faturës Nr. 546/2021 të datës 23.04.2021; Faturës Nr. 512/2021 të datës 16.04.2021; Faturës Nr. 472/2021 të datës 08.04.2021; Faturës Nr. 421/2021 të datës 29.03.2021; Faturës Nr. 394/2021 të datës 19.03.2021; Faturës Nr. 381/2021 të datës 16.03.2021; Faturës Nr. 331/2021 të datës 06.03.2021; Faturës Nr. 268/2021 të datës 25.02.2021; Faturës Nr. 257/2021 të datës 23.02.2021; Faturës Nr. 231/2021 të datës 19.02.2021; Faturës Nr. 204/2021 të datës 11.02.2021; Faturës Nr. 171/2021 të datës 08.02.2021; Faturës Nr. 121/2021 të datës 25.01.2021; Faturës Nr. 23/2021 të datës 08.01.2021 dhe Faturës Nr. 22/2021 të datës 07.01.2021; me të cilën është detyruar debitori që sipas faturave të lartcekura t’ia paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 14,883.15 €, me kamatëvonesë prej 8%, duke llogaritur nga data kur kredia është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore, në afat prej 7 ditësh, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm, ashtu që të gjitha këto detyrime duhet të realizohen përmes zbatimit të përmbarimit sipas llogarive bankare të debitorit dhe bartjen e tyre në llogarinë e veçantë të përmbaresit privat për të përfunduar në llogari të kreditorit, ndërsa nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogaritë e tij bankare, përmbarimi të zbatohet përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme derisa të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesve të autorizuar, ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar ndër të tjerash se kreditori me datë 01.06.2022 ka lëshuar propozimin për përmbarim, ndërsa në të njëjtën datë me 01.06.2022

përmbaruesi privat ka nxjerr urdhrin përmbarimor, duke mos i lënë afat për pagesë debitorit. Më tutje ka shtuar se faturat nuk i përmbajnë kushtet ligjore, për arsye se janë kopje të noterizuara, si dhe nuk e përmbajnë adresën e saktë të debitorit dhe se për të njëjtat nuk dihet se a ka arritur afati i pagesës. I ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta aprovojë në tërësi si të bazuar dhe ta shfuqizojë urdhrin përmbarimor.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesve të autorizuar, ka deklaruar se prapësimi i debitorit nuk mbështetet në asnjë provë dhe se nuk i plotëson kushtet formale të saj. Në lidhje me pretendimin rreth afatit për pagesë, ka theksuar se nuk qëndron, sepse në propozimin për përmbarim i lejuar nga përmbaruesi privat debitori e ka pasur afatin e përmbushjes, gjithashtu të gjitha faturat kanë datën e lëshimit si dhe afatin për pagesë. Më tutje ka shtuar se të gjitha faturat janë në origjinal dhe të njëjtat janë dorëzuar në këtë formë së bashku me propozimin për përmbarim, ndërsa rreth adresës së debitorit ka deklaruar se përmban të dhënat e sakta. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit, të lihet në fuqi urdhri përmbarimor dhe në rast të ushtrimit të ankesës nga debitori e njëjtat të urdhërohet të paguaj garancionin e shumës së borxhit kryesor, si dhe të detyrohet debitori që të paguaj në tërësi shpenzimet e procedurës përmbarimore duke përfshirë edhe shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim në shumën prej 208.00 € sipas tarifës së OAK.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbarim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par.

3 të LPP-së, përcaktohet se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbardim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar* “. Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “*Kur propozimi për përmbardim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.*”, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbardimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbarduesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - Faturën Nr. 1309 të datës 04.11.2019; Faturën Nr. 1692/2021 të datës 16.11.2021; Faturën Nr. 1324/2021 të datës 16.09.2021; Faturën Nr. 1226/2021 të datës 30.08.2021; Faturën Nr. 1225/2021 të datës 30.08.2021; Faturën Nr. 1169/2021 të datës 17.08.2021; Faturën Nr. 1148/2021 të datës 12.08.2021; Faturën Nr. 1070/2021 të datës 02.08.2021; Faturën Nr. 1049/2021 të datës 27.07.2021; Faturën Nr. 992/2021 të datës 14.07.2021; Faturën Nr. 965/2021 të datës 09.07.2021; Faturën Nr. 954/2021 të datës 06.07.2021; Faturën Nr. 923/2021 të datës 02.07.2021; Faturën Nr. 905/2021 të datës 28.06.2021; Faturën Nr. 904/2021 të datës 26.06.2021; Faturën Nr. 903/2021 të datës 25.06.2021; Faturën Nr. 870/2021 të datës 21.06.2021; Faturën Nr. 703/2021 të datës 25.05.2021; Faturën Nr. 700/2021; Faturën Nr. 695/2021 të datës 25.05.2021; Faturën Nr. 669/2021 të datës 21.05.2021; Faturën Nr. 639/2021 të datës 12.05.2021; Faturën Nr. 626/2021 të datës 10.05.2021; Faturën Nr. 610/2021 të datës 05.05.2021; Faturën Nr. 569/2021 të datës 27.04.2021; Faturën Nr. 546/2021 të datës 23.04.2021; Faturën Nr. 512/2021 të datës 16.04.2021; Faturën Nr. 472/2021 të datës 08.04.2021; Faturën Nr. 421/2021 të datës 29.03.2021; Faturën Nr. 394/2021 të datës 19.03.2021; Faturën Nr. 381/2021 të datës 16.03.2021; Faturën Nr. 331/2021 të datës 06.03.2021; Faturën Nr. 268/2021 të datës 25.02.2021; Faturën Nr. 257/2021 të datës 23.02.2021; Faturën Nr. 231/2021 të datës 19.02.2021; Faturën Nr. 204/2021 të datës 11.02.2021; Faturën Nr. 171/2021 të datës 08.02.2021; Faturën Nr. 121/2021 të datës 25.01.2021; Faturën Nr. 23/2021 të datës 08.01.2021 dhe Faturën Nr. 22/2021 të datës 07.01.2021, i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave është përcaktuar shuma e cila përben detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, mbajnë vulën si dhe nënshkrimin e pranimit të debitorit, si dhe nuk janë kontestuar asnjëherë nga debitori.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit se në faturën e kreditorit nuk është treguar koha e përmbushjes së detyrimit monetar dhe gjeti se e njëjta nuk gjen mbështetje ligjore, sepse në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm për faktin se afati i përmbushjes së detyrimit është përcaktuar në faturë. Për më tepër fatura e cila nuk përmban afat të përmbushjes nga data e lëshimit të faturës, nënkuptohet se afati për përmbushje arrin menjëherë respektivisht në datën e lëshimit të faturës.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbarimi.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbarimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke i' a njohur shpenzimet e të autorizuarit të kreditorit për përpilimin e përgjigjes në prapësim dhe atë në shumën prej 104.00 € (njëqind e katër euro), siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifën e avokatëve, të datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.895/23, datë 05.04.2024

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.